



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR TË BASHKISË DURRËS TË
PROPOZUAR NGA KOALICIONI "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE" ZNJ.VALBONA
SIMO SAKO PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30
QERDHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 15.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës znj. Valbona Simo Sako të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a" neni 67, pika 2, neni 165, pika 3 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 07.05.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane". Sipas marrëveshjes së Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", kryetari i Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Edi Kristaq Rama do të jetë personi i cili do të



Nr. 398 i Vendimit

Data 15.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", znj. Valbona Sako për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

autorizojë personat përgjegjës për të firmosur në emër të koalicionit kërkesën për rregjistrimin e kandidatëve për Kryetar Bashkie.

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" ka depozituar në KQZ Kërkesën për rregjistrimin e znj. Valbona Simo Sako si kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të rregjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkisë Durrës, pasi Bashkia Durrës, administrohet nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë listuar:

1. Kërkesë për regjistrimin e znj. Valbona Simo Sako si kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës;
2. Deklaratat e kandidatit i cili deklaron se gëzon të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për Kryetar në Bashkinë Durrës, të propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019;
3. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
4. Kopje e letërnjoftimit të znj. Valbona Simo Sako sipas së cilës rezulton se znj. Valbona Simo Sako është me vendbanim në Bashkinë Durrës;
5. Jetëshkrimin të znj. Valbona Simo Sako si kandidat për kryetar të bashkisë Durrës;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për të kandidatit për kryetar bashkie. KQZ gjithashtu ka publikuar formularin e vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve znj. Valbona Simo Sako nuk është në kushtet e nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, për refuzimin e tij si kandidat për kryetar bashkie, propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 15.05.2019, verifikoi dokumentacionin e kandidimit për kryetar znj. Valbona Simo Sako në Bashkinë Durrës, të depozituar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, neni 165 nenin 72 dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".



Nr. 398 i Vendimit

Data 15.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", znj. Valbona Sako për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

V E N D O S I:

1. Të regjistrojë si kandidat për Kryetar në Bashkinë Durrës për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, znj. Valbona Simo Sako të propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 398 i Vendimit

Data 15.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", znj. Valbona Sako për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.